



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Nr. 1221 Prot.

Tiranë, më 18.07.2022

**THIRRJA E HAPUR PËR PËZGJEDHJEN E SHTËPIVE KINEMATOGRAFIKE
QË DO TË REALIZOJNË PROJEKTET FILMIKE NË KUADËR TË “PAKTIT PËR
UNIVERSITETIN”**

Universiteti i Arteve, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, dhe Qendrën Kombëtare të Kinematografisë në datën 30.06.2022, kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit në mbështetje të programit Kombëtar “Pakti për Universitetin”. Ndër të tjera në Memorandumin e Bashkëpunimit palët kanë marrë angazhimin për të vazhduar mbështetjen financiare të projekteve filmike temë diplome të studentëve të vitit të 3-të në studimet Bachelor, në Fakultetin e Artit Skenik, dega “Regji Filmi dhe Televizioni”, për vitin akademik 2021-2022.

Në përmbushje të angazhimit të sipërpërmendur, shpallim thirrjen publike për përzgjedhjen e shtëpive kinematografike që do të marrin përsipër të realizojnë këto projekte.

Shtëpitë filmike do të vlerësohen mbi dosjet e paraqitura nga një Komision Ad-Hoc i ngritur pranë UART dhe QKK me ekspertë dhe profesionistë të fushës.

Kriteret përzgjedhëse janë si vijon:

- Shtëpia kinematografike do të angazhohet në jo më shumë se dy (2) projekte filmike brenda kësaj thirrjeje publike.
- Shtëpia kinematografike duhet të ketë eksperiencë në realizimin e filmave artistikë me metrazh të gjatë dhe të shkurtër.
- Shtëpia kinematografike duhet të ofrojë/sigurojë shërbimet e një trupe profesionale në çdo sektor të punës, në shërbim të projekteve.
- Shtëpia kinematografike duhet të ketë aftësinë e promovimit të filmave jo vetëm në tregun vendas por edhe në festivale apo evente filmike të të njëjtit nivel apo më mirë.
- Shtëpia kinematografike duhet të angazhojë aktorë profesionistë (brenda buxhetit të përcaktuar) me dy qëllime: të jenë një mundësi për regjisorët e rinj për t’u përballur me aktorët dhe për të realizuar figura sa më cilësore, por gjithashtu edhe për të patur figura publike që mundësojnë një promovim të suksesshëm të këtyre filmave.
- Shtëpia kinematografike duhet të plotësojë kërkesat për realizimin e skenave (dekoreve) dhe kostumeve sipas përcaktimit në skenarët e miratuara nga UART apo t’i ofrojë/sigurojë këto skena dhe kostume brenda buxhetit të përcaktuar.

- Shtëpia kinematografike duhet të garantojë post produksionin e filmave në kohë dhe me cilësi, duke respektuar kërkesat e studentit regjisor dhe pedagogut të tij.
- Duke qenë se kinematografia është një industri e cila evoluon me ritme të shpejta nga ana teknike, duhet që studentëve t'u ofrohet mundësia të njihen, përdorin dhe xhirojnë me mjete teknike bashkëkohore, të cilat shtëpia kinematografike do t'i vërë në dispozicion të studentëve brenda buxhetit të përcaktuar.
- Shtëpia filmike duhet të garantojë që aktorët e kontraktuar të jenë pjesë e promovimeve (në rast se do të ketë) të këtyre realizimeve, brenda ose jashtë Shqipërisë kur kjo kërkohet nga RRFTV/FAS.
- Shtëpia filmike duhet të sigurojë ruajtjen në arkivën e saj të projekteve të dala nga ky bashkëpunim pavarësisht kopjeve që dorëzon në UART apo QKK.
- Shtëpia filmike duhet të sigurojë ruajtjen në arkivën e saj të projekteve të dala nga ky bashkëpunim pavarësisht kopjeve që dorëzon në UART apo QKK.
- Punët e realizuara nga ky bashkëpunim janë vepra të krijuara për publikun dhe shtëpia filmike duhet të sigurojë të gjitha kushtet që ato t'i paraqiten publikut në rast se FAS/UART do ta ketë të pamundur ta bëjë këtë në ambientet e veta.
- Shtëpia filmike duhet të plotësojë të gjitha kërkesat ligjore dhe financiare që lindin gjatë bashkëpunimit me QKK dhe UART.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet:

Kërkesë për pjesëmarrje në procedurën e përzgjedhjes.

1. Vërtetim që shtëpia kinematografike është e regjistruar në Qendrën Kombëtare e Kinematografisë për vitin 2022.
2. CV e shtëpisë kinematografike ku të pasqyrohet aktiviteti i saj.
3. Shënimet e Producentit, ku të pasqyrohet vizioni i producentit për realizimin e projekteve, si dhe strategjia e produksionit dhe distribucionit. (deri 3 faqe).
4. Link/s të filmit/ave artistikë të metrazhit të gjatë të realizuar nga shtëpia kinematografike.
5. Link/s të filmit/ave artistikë të metrazhit të shkurtër të realizuar nga shtëpia kinematografike.
6. Link/s të festivaleve ku ka marrë pjesë filmi/at e prodhuar prej tij dhe vlerësimet me çmime (në rast se ka).
7. Deklaratë në përgjegjësi personale që konfirmon se disponon të gjithë aftësinë profesionale për të realizuar dy projektet kinematografike me standart të lartë, duke vënë në dispozicion të autorëve studentë mjetet teknike të xhirit dhe të postproduksionit në standarte të larta, sipas kërkesave të dakordësuara me pedagogun e lëndës.
8. Deklaratë në përgjegjësi personale që konfirmon se projektet do të realizohen me mbështetjen financiare të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, konform procedurave administrative dhe rregullimeve financiare me të cilat operon institucioni.
9. Vetëdeklaratë mbi konfliktin e interesit, bazuar në ligjin me nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" të ndryshuar.



10. Dokumenta konfirmuese që tregojnë asete që kompania ka në porsesi (opsionale, në rast se ka).

- **Afati i aplikimeve :**
18.07.2022

- **Shpallja e fituesve:**
01.08.2022

- Dokumentacioni fizik dhe online dorëzohet pranë njësisë së protokollit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, Rruga. "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë.

REKTOR

Prof. KASTRIOT ÇAUSHI

